

Raport përmbledhës i monitorimit të zbatimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike të Qeverisë

08/2022

Autori: Institute for Development Policy (INDEP)

Programi: Qeverisja Demokratike

Publikuar: Korrik, 2022

Të gjeturat, opinionet dhe rekomandimet e këtij raporti nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Balkan Trust for Democracy, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, USAID-it apo të Qeverisë Amerikane.

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	3
Hyrje	4
Metodologjia	5
Përmbledhje e përgjithshme sa i përket Pakos së Ringjalljes Ekonomike	6
Raporti i Zbatimit	8
Masa 1 - Mbështetja e Punësimit.....	8
Niveli i Zbatimit	9
Masa 2 - Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit.....	12
Niveli i Zbatimit	13
Masa 3 - Mbështetja për familjen	14
Niveli i Zbatimit	15
Masa 4 - Mbështetja për publikun	18
Niveli i Zbatimit	18
Masa 5 - Investimi në infrastrukturë dhe ambient.....	21
Përfundime.....	23

Lista e shkurtesave

ATK – Administrata Tatimore e Kosovës

APRK – Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

BKS – Byroja Kosovare e Sigurimit

FKGK – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

INDEP – Instituti për Politika Zhvillimore

MASHT – Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit

ME – Ministria e Ekonomisë

MFPT – Ministria e Financës, Punës dhe Transfereve

MINT – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

MKRS – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

MSH – Ministria e Shëndetësisë

PRE – Pakoja e Ringjalljes Ekonomike

STEM – Fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës

TI – Teknologjia e informacionit

Hyrje

Për të tejkaluar pasojat dhe dëmet e shkaktuara nga pandemia COVID-19, u hartuan dhe aplikuan masa lehtësimi nga qeveritë e vendeve të ndryshme globalisht. Natyrisht, pandemia la gjurmë dhe preku këdo në një dimension apo tjetër, e në vende më pak të zhvilluara ekonomikisht la pasoja edhe më të mëdha. Padyshim një ndër vendet e prekura dhe me nevojë të madhe për rikuperim ishte edhe Kosova, të cilës pandemia i shkaktoi humbje të dukshme në dimensione ekonomike dhe sociale. Për të reduktuar dëmet dhe pasojat e shkaktuara nga pandemia, Qeveria mori një varg masash në kuadër të disa pakove ekonomike, të cilat tentuan rikuperimin kryesisht ekonomik. Megjithatë, pako të caktuara si Pakoja e fundit e quajtur Pako e Ringjalljes Ekonomike që u miratua në muajin korrik të vitit 2021, pati për qëllim të rikuperojë dimensionin ekonomik dhe social por në një mënyrë të qëndrueshme. Kjo duke dedikuar masa të cilat ju kushtuan plotësisht rikuperimit të gjelbër dhe tranzicionit në energji të gjelbër.

Pakoja e Ringjalljes Ekonomike synon zhvillimin e mirëqenies ekonomike dhe sociale. Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, në vlerë prej 420 milionë euro, pati të përfshirë mbështetje për punësimin, familjet, prodhimtarinë dhe sektorin publik si dhe investime në infrastrukturë dhe mjedis. Ko Pako u konsiderua një ndër pakot me rëndësi të madhe sepse prej saj derivuan edhe masa të rëndësishme të cilat ngelën pjesë e sistemit dhe u shndërruan në politika të përhershme. Pakoja gjithashtu synoi edhe adresimin e nevojave të shumta për të filluar rrugën drejtë përparimit të Agjendës së Gjelbër, e megjithëse nuk u bë shumë në këtë drejtim, ka projekte që kanë filluar gradualisht

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), në kuadër të projektit “Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri”, projekt i cili mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD) dhe USAID-i, ka analizuar dhe monitoruar procesin e implementimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, në faza periodike. Procesi i analizës dhe monitorimit bëhet në mënyra të ndryshme, përmes raporteve monitoruese dhe infografikave. Ky raport i rradhës, është raporti i tretë dhe njëkohësisht i fundit i monitorimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Raporti i tretë i monitorimit është fokusuar në të dhënat e marra nga Ministria e Financave, Ministria e Arsimit, Administrata Tatimore e Kosovës, Byroja Kosovare e Sigurimit, Agjencia e Punësimit të Kosovës, Fondi për Garanci Kreditorë e insitucione të tjera përgjegjëse.

Raporti i tretë i monitorimit është i realizuar në kuadër të procesit të monitorimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, dhe është përpiluar duke monitoruar gjithë periudhën e zbatimit të masave të Pakos së Ringjalljes. Në përgjithësi, procesi i monitorimit përfshin edhe publikimin e buletineve të cilët deri tani kanë arritur shifrën 7, gjithsej 12 infografikave informuese, 3 podkastëve dhe 2 diskutimeve live me akterë të rëndësishëm me të cilët analizohet Pakoja e Ringjalljes dhe gjendja aktuale në raport me pandeminë COVID-19. Të gjitha këto aktivitete kanë për qëllim informimin e qytetarëve rreth masave mbështetëse të Pakos si dhe zbatimit të saj. Këto aktivitete të Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) tentojnë që të rrisin transparencën dhe llogaridhënien, e në të njëjtën kohë të mbajnë të informuar qytetarët rreth masave dhe përfitimeve që kanë ata ndaj Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti të monitorimit është përdorur metodologji e përzier që përmban metodën kërkimore cilësore dhe sasiore. Për përpilimin e këtij raporti u punua duke u përdorur metoda kërkimore cilësore, duke konsultuar dokumente përkatëse dhe duke mbledhur të dhëna dhe informata në burime të ndryshme, rreth zbatimit të masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Krahas kësaj në mënyrë që ky raport të jetë sa më i plotë, INDEP ka plotësuar gamën e informatave cilësore edhe përmes kërkimit sasior. Gjatë procesit të përpilimit të raportit, INDEP ka organizuar takime dhe diskutime gjysmë të strukturuar me përfaqësues të institucioneve, entiteteve ekonomike dhe akterëve të tjerë relevantë, në mënyrë që të marrë informata të sakta dhe koherente për zbatimin e Pakos së Ringjalljes. INDEP gjithashtu ka përdorur metodën e vëzhgimit për të vlerësuar procesin e zbatimit, për të parë nga afër atë dhe për të vështruar sjelljen e akterëve zbatues përgjatë një kohështrirje prej katër muajve.

Pas mbledhjes së të dhënave, analiza e të dhënave ka kaluar në dy faza kryesore. Në fazën e parë, INDEP ka sistemuar të dhënat dhe ka bërë një analizë të përmbajtjes. Në pjesën e dytë, është bërë tabulimi i të dhënave nga kërkimi cilësor me përfundimet e nxjerra nga intervistat për të nxjerrë qëndrimet përfundimtare. Në fund, raporti ka kaluar edhe nëpër një analizë të përgjithshme të kontekstit zhvillimor të Kosovës ku edhe është përshkallëzuar niveli i zbatimit të masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Shkallëzimi i nivelit të zbatimit të masave është ndarë në katër nivele. Këto nivele janë:

1. Pa zbatim

Masa nuk ka filluar funksionalizimin dhe INDEP nuk ka gjetur të dhëna që masa ka filluar të implementohet

2. Zbatim i kufizuar

Masa është funksionalizuar por INDEP nuk ka gjetur të dhëna që masa ka filluar të implementohet

3. Zbatim i pjesshëm

Masa është funksionalizuar dhe INDEP ka gjetur të dhëna që masa është duke u implementuar

4. Zbatim i plotë

Masa është funksionalizuar dhe INDEP ka gjetur të dhëna që masa është implementuar plotësisht

Përmes këtij shkallëzimi do të paraqesim nivelin e zbatimit aktual të masave që përmban kjo pako e ndihmave ekonomike.

Të dhënat e këtij raporti janë marrë nga Ministria e Financave, Ministria e Arsimit, Administrata Tatimore e Kosovës, Byroja Kosovare e Sigurimit, Agjencia e Punësimit të Kosovës, Fondi për Garanci Kreditorë e institucione të tjera përgjegjëse. Këto të dhëna ndihmojnë në krahasimin dhe përcaktimin e nivelit të zbatimit të masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Përmes këtyre të

dhënave, INDEP synon informimin e qytetarëve dhe akterëve relevantë mbi procesin e implementimit të Pakos së Ringjalljes.

Përmbledhje e përgjithshme sa i përket Pakos së Ringjalljes Ekonomike

Pakoja e Ringjalljes Ekonomike ka gjithsej 5 masa, nën të cilat përfshihen 3-7 nënmasa. Masat kanë synuar ringjalljen dhe formalizimin e ekonomisë, punësimin e të rinjve përmes skemave të praktikës, stimulimin e prodhimit vendor, ngritjen e kapaciteteve në arsim, shëndetësinë, mbështetjen për ndërmarrjet publike si dhe mbështetja e grupeve të cënueshme përmes skemave sociale të ristrukturuara. Qeveria ka alokuar mjete financiare prej gjithsej 420 milionë euro për Pakon e Ringjalljes, duke pasur në fokus zbutjen e pasojave socio-ekonomike për kategoritë më të cënueshme dhe të prekura nga pandemia.

Përderisa Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është institucioni përgjegjës për përpilimin e këtyre masave, ka pasur edhe institucione tjera të përfshira në procesin e përpilimit dhe zbatimit të këtyre masave. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë si dhe agjenci të pavarura si Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencia e Punësimit, Byroja Kosova e Sigurimit, Universitetet Publike, Odat Ekonomike, Ndërmarrjet Publike si dhe Komunitetet e Kosovës kanë luajtur rol kyq në përpilimin apo zbatimin e disa prej masave të Pakos.

Për zbatimin e Pakos së Ringjalljes prej 430 milionë euro mjete të alokuara, 190 milionë euro janë të financuar përmes buxhetit të Republikës së Kosovës, ndërsa pjesa tjetër prej 230 milionë Euro janë financuar përmes huamarrjes. Edhe pse e buxhetuar fillimisht vetëm për vitin 2021, Pakoja e Ringjalljes ka vazhduar të zbatohet edhe në vitin 2022. Me miratimin e mjeteve financiare të alokuara për Pakon e Ringjalljes, për të cilat mjete u rishikua buxheti i vitit 2021 u bë ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 07/ L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Duhet të përmendet që me vazhdimin e zbatimit të kësaj Pakoje, në ndarjen buxhetore për vitin 2022 është buxhetuar shumë tjetër nga ajo që është deklaruar nga institucionet publike se do të mbështetet zbatimi i masave. Megjithatë duhet patur parasysh se ka masa për të cilat është deklaruar të zbatohen në kuadër të projekteve të ndryshme dhe huamarrjes.

Gjithsesi, para se të thellohem në analizën dhe raportin e monitorimit të secilës masë, duhet përmendur se INDEP gjatë monitorimit të procesit të përpilimit dhe zbatimit të masave ka vënë re dhe ka theksuar vazhdimisht se ka pasur lëshime të caktuara në procesin e përpilimit të Pakos së Ringjalljes, dhe më pas edhe të zbatimit duke qenë se ka pasur masa të cilat gjatë gjithë kësaj periudhe nuk kanë filluar të zbatohen fare. Fakti që Qeveria nuk e ka vendosur në konsultim publik një iniciativë të tillë si projekti i pakos, është konsideruar mungesë transparence duke qenë se Pakoja e Ringjalljes është një ndër projektet më të mëdha rikuperuese pas pandemisë COVID-19 i cili ka të alokuar mjete financiare në shumën të mëdha dhe përmban politika dhe masa të cilat afektojnë të gjithë. Për të vazhduar pastaj me obligimin që kanë institucionet publike, në këtë rast Qeveria për të vendosur në konsultim publik të gjitha projektligjet, iniciativat e projektet e këtilla në mënyrë që shoqëria civile, qytetarët e akterë të tjerë të konsultohen për projekte të tilla.

Duhet përmendur se përveç masave të parapara fillimisht, ka pasur masa të tjera të ndërmarra në mënyrë ad-hoc, si 'Mbështetja e njëhershme në vlerë prej 100 euro për grupe të caktuara në shoqëri', si dhe ka pasur masa të cilat janë shndërruar në politika dhe janë bërë të përhershme. Kjo para së gjithash është me rëndësi të madhe sepse adreson nevojat e disa grupeve të cenueshme, gratë të cilat nuk kanë qenë të përfshira ndonjëherë më parë në skema të tilla dhe nuk janë mbështetur asnjëherë nga shteti.

Meqenëse pako ka synuar prekjen e tri dimensioneve përgjatë zbatimit, shkurtimisht do t'i shpërfaqim ato në këtë përmbledhje dhe gjatë raportimit të monitorimit të secilës masë. *Dimensioni social* është i prekur kryesisht në masat 1 dhe 3, respektivisht në nën-masat për rikthimin në punë të atyre që kanë humbur punën gjatë pandemisë, mbështetjen për të punësuarit e formalizuar, gratë dhe personat me nevoja të veçanta, mbështetjen për familjet që kanë humbur kryefamiljarin dhe për pensionistët dhe familjet me nevoja të veçanta, si dhe reformimin e skemës së asistencës sociale duke integruar këtu edhe pagesat për lehonat, si dhe studentët. INDEP gjatë monitorimit të zbatimit të kësaj pakoje, ka vërejtur se që në përpilimin e projektit të pakos janë anashkaluar faktorë të rëndësishëm, si gjithëpërfshirja dhe disa nga masat e caktuara konsiderohen të kenë qenë jo-gjithëpërfshirëse, shpesh duke lënë anash tërësisht grupe të caktuara të shoqërisë, psh. të papunët, (përveç në rastet e të papunëve që kanë humbur punën gjatë pandemisë) duke mos i përfshirë në asnjë masë, madje as edhe në 'mbështetjen prej 100 eurosh', dhe si rrjedhojë do të ndodhte një shpërndarje e pabarabartë e mjeteve financiare. Kjo ka shpërfaqur në përfundimin që në raste të caktuara masat e zbatuar nga pako janë konsideruar diskriminuese, dhe jo mbështetëse ndaj disa grupeve të caktuara në shoqëri. Kjo mund të ketë ndodhur si pasojë e mungesës së bashkëpunimit me palë të tjera, dhe përpilimit të projektit të pakos në mënyrë ad-hoc. Megjithatë ndryshime pozitive ka pasur si rrjedhojë e zbatimit të Pakos, dhe fakti që disa nga masat kanë mbetur të përhershme dhe janë shndërruar në politika, konsiderohet jashtëzakonisht pozitive. Rast konkret është skema mbështetëse postnatale, e cila nuk ka ekzistuar më parë, që mbështet financiarisht dhe mundohet të lehtësojë dhe reduktojë shpenzimet për nënat lehonat të papunësuarat si dhe të posalindurit, si dhe duke ndihmuar me mjete financiare foshnjat dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare.

Sa i përket *dimensionit ekonomik*, mund të themi që të gjitha masat dhe nënmasat kanë vlera dhe indikatorë të matshëm ekonomikë, duke filluar nga mbështetjet për kompanitë, punëmarrësit e punëdhënësit, subvencionet për familjet në nevojë, subvencionimi agrokulturor, qasje e lehtësuar në huamarrje, si dhe punësim. Këto mjete financiare të alokuara përmes skemave dhe programeve të ndryshme kanë qenë shtyese dhe injektim në ekonominë kosovare, si dhe kanë ndikuar në rimëkëmbje ekonomike. Megjithatë, mungesa e bashkëpunimit me palë të treta ka qenë e dukshme dhe ka reflektuar edhe në këtë dimension. Fakti që nuk janë përfshirë akterë ekonomike në fazat fillestare të projektimit të pakos, ka pamundësuar një zbatim efektiv të masave. E rëndësishme të përmendet është edhe mungesa e zbatimit në mënyrë paralele të të gjitha masave.¹Për arsye të caktuara, Qeveria ka zbatuar nënmasa të caktuara plotësisht dhe me vullshëm, ndërsa ka lënë masa të tjera të pazbatuara në plotëni.

¹ INDEP, Pako e Ringjalljes Ekonomike (PRE) – Vrojtimi i efekteve të PRE-së në ekonominë e Kosovës, 2022, i qasshëm në https://indep.info/wp-content/uploads/2022/05/BTD_INDEP_Punimi-3_ALB.pdf (qasur në qershor, 2022)

Edhe pse fillimisht e promovuar si Pako që ka për qëllim rimëkëmbjen e gjelbër, pakoja pak ka pasur të përfshirë *dimensioni mjedisor* në masat e saj. Përvec masës së pestë, e cila i është dedikuar totalisht investimit në infrastrukturë dhe ambient, te masat tjera ka pasur pak nënmasa që kanë të përfshirë tranzicionin drejtë të gjelbrës. Përfshirë bën masa e dytë, e cila poashtu ka dy nënmasa të cilat janë mbështetja e eksportit dhe ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agroturizimit. Masa e pestë është një ndër masat më pak të zbatuara, për të mos thënë fare, përveç një projekti që është në fazë fillestare e që do të elaborohet më poshtë. Pak është bërë edhe në dy nënmasat e cekura më lart, përveç disa subvencioneve të drejtuara në agrikulturë. Mungesa e zbatimit të masave dhe e përfshirjes së dimensionit mjedisor në Pako, ekziston poashtu si pasojë e mungesës së planifikimit në faza fillestare dhe harmonizimit me projektet aktuale në këtë drejtim.

Raporti i Zbatimit

Masa 1 - Mbështetja e Punësimit

Masa e parë e Pakos së Ringjalljes, ka pasur të ndarë gjithsej 50 milionë euro. Masa ka synuar ripunësimin e atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë si dhe formalizimin e ekonomisë kosovare, që njihet për ekonomi informale. Për më tepër masa ofroj mbështetje edhe për grupet e cenueshme si gratë dhe personat me nevoja të veçanta, dhe kishte në fokus fuqizimin e grave si dhe punësimin e të rinjve, përmes skemave të ndryshme të praktikës. Masa synoj edhe mbështetje për punëtorët e formalizuar si dhe synoj avancimin e të rinjve kosovarë drejtë fushës së teknologjisë së informacionit. Mbështetja për grupet e targetuara nga kjo masë është si në vijim:

1. Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë
2. Mbështetja për të punësuarit e formalizuar
3. Mbështetja e punësimit të grave
4. Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë
5. Trajnimi dhe punësimi në TI
6. Mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta
7. Skema e granteve për zanatet

Objektiva kryesore e kësaj mase është fuqizimi i ekonomisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, duke u orientuar sidomos drejtë fuqizimit të grave dhe të rinjve. Por, masa tentoi që poashtu të formalizonte ekonominë, që është në nivel të lartë të informalitetit në Kosovë, dhe e cila vlerësohet të jetë diku rreth 26-34% të GDP-së.² Masa ka tentuar të ndikojë pozitivisht në këtë aspekt duke shtyrë punëdhënësit të deklarojnë punëtorët duke ju ofruar rimbursime në formë parash. Padyshim që përveç incentivave në formalizimin e ekonomisë dhe fuqizimin e punëtorëve dhe grave, masa pati në fokus edhe të rinjtë dhe grupet me nevoja të veçanta. Përmes skemave të praktikës në bashkëpunim me institucione të ndryshme qindra studentëve iu ofrua vend pune për periudha të caktuara, duke ndikuar kështu edhe në përgatitjen për treg të punës. Masa 1 synoi edhe

² Hasanaj Bedri, Karakteristikat e rritjes ekonomike të Kosovës në dekadën e fundit, Prishtinë 2018, i qasshëm në <https://bqk-kos.org/edu/wp-content/uploads/2021/02/Karakteristikat-e-Rritjes-ekonomike-te-Kosoves-Bedri-HASANAJ.pdf> (qasur në qershor, 2022)

ngritjen e kapaciteteve të të rinjve në fushën e teknologjisë së informacionit, duke ofruar mundësi aftësimi profesional për të rinjtë e interesuar në fushën e TI-së.

Niveli i Zbatimit

Edhe pse ky është raporti përmbledhës monitorues për zbatimin e masave që dalin nga Pakoja e Ringjalljes, ka masa që ende vazhdojnë të zbatohen, dhe janë planifikuar me ndarjen buxhetore të vitit 2022 të zbatohen deri në fund të vitit. Megjithatë, ka edhe nga masat të cilat janë zbatuar në tërësi, p.sh masa 1.1, rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë është zbatuar dhe për këtë grup të synuar janë subvencionuar paga deri në 50% të pagës mujore bruto për 3 muaj. Ndërsa sa i përket masave 1.2 dhe 1.3, këto të fundit kanë pasur kohëzgjatjen e subvencionimit deri në fund të muajit qershor 2022, në mënyrë që të ketë hapësirë të mjaftueshme

për zbatimin e masave për mbështetje të punëtorëve të formalizuar dhe grave. Duhet të përmendet se këto masa u projektuan dhe zbatuan në bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës.

Për të verifikuar subvencionimin nga Pakoja e Ringjalljes, ATK ka mundur edhe një vegël shtesë e cila është në dispozicion të tatimpaguesve dhe përmes së cilës çdo punëdhënës me anë të numrit identifikues mund të bëjë verifikimin e punëmarrësit se a mund të jetë përfitues ose jo.

Masa 1.4 është masë e cila i kushtohet plotësisht skemës së garantuar për punësim të të rinjve. Si hap fillestar, masa parashihet përmirësimin e cilësisë së edukimit profesional, rritjen e numrit të profileve të ofruara nga Qendrat për Edukim Profesional si dhe akreditimin e tyre, zgjerimin e mundësive të të mësuarit nga praktika, ofrimin e edukimit profesional për të rritur si dhe njohjen e mësimin paraprak. Kjo masë ka paralajmëruar zbatimin që nga nëntori i vitit 2021, megjithatë ka filluar më vonë të zbatohet. Në kuadër të kësaj mase deri tani është implementuar 1 projekt. Projekti është në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës. Ky projekt ka paraparë fillimisht 170 përfitues, por për shkak të mungesës së aplikantëve dhe mosmarrëveshjeve për kushtet e kontratës, në fazën e fundit kanë mbetur gjithsej 63 (pra janë punësuar 63 persona gjithsej). Kriter esencial për aplikantët ka qenë të kenë përfunduar studimet në Universitetin e Prishtinës në fushën e mirëqenies sociale. Kjo masë ka pasur për qëllim punësimin e studentëve të dalluar të universiteteve publike, në mënyrë që të aftësohen dhe zhvillohen profesionalisht.




Figura 1. Niveli i zbatimit të masës 'Mbështetja për familjen'

Tabela 1. Të dhëna për të punësuarit të ndara në komuna (përfituesit – P)

Komuna	P	Komuna	P	Komuna	P	Komuna	P	Komuna	P
Deçan	3	Gjilan	6	Shtime	1	Klinë	1	Prizren	1
Drenas	1	Hani i Elezit	2	Suharekë	1	Lipjan	9	Rahovec	1
Ferizaj	2	Istog	4	Vushtrri	4	Malishevë	4	Skënderaj	6
Fushë Kosovë	1	Podujevë	8	Kaçanik	1	Novobërdë	1	Viti	1
Gjakovë	1	Prishtinë	6	Kamenicë	1	Pejë	1		

Përfituesit e kësaj mase do të përfundojnë praktikën për zhvillim profesional në Qendra për Punë Sociale (QPS), Zyra e Pensioneve, Qendrat për të Moshuar, Qendrat për Aftësi të Kufizuar dhe OJQ-të e licencuara në komunën përkatëse. Për më tepër në kuadër të kësaj mase do të zbatohen edhe dy projekte tjera që momentalisht janë në fazë fillestare me GIZ dhe UNICEF. Momentalisht janë duke u planifikuar edhe dy projekte të tjera me GIZ dhe Unicef. Projekti i dytë, quhet “Aftësitë për Tregun e Punës – Fit for Job” dhe zbatohet në bashkë-financim me GIZ, dhe ka të menduar punësimin e 300 të rinjve.³ Megjithatë këto projekte janë ende në faza fillestare, dhe nuk ka të dhëna zyrtare për to. Por duhet theksuar se zbatimi i kësaj mase bie nën përgjegjësinë e APRK-së.

Masa 1.5 ‘Trajnimi dhe punësimi në TI’, ka pasur të alokuar mjete financiare në shumë prej 5 milionë euro, dhe kjo masë mund të themi se është zbatuar gati në plotëni. Masa ka paraparë ndarjen e kuponëve për maturantët e interesuar për zhvillim profesional në fushën e teknologjisë informative. Poashtu në kuadër të kësaj mase është përfshirë mbështetja financiare e studenteve vajza/gra në fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës (STEM), të arsimit të lartë në Kosovë. Sipas të dhënave zyrtare të publikuara në webfaqen e MASHT, janë hapur programe aplikimi, ku maturantët dhe vajzat në STEM kanë aplikuar dhe janë përzgjedhur sipas kriterëve të caktuar. Maturantët përfitues kanë qenë **943 sosh**⁴, që janë përzgjedhur për të ndjekur kurse në trajnimit në fushën e TI-së. Ndërsa sa i përket mbështetjes financiare të ofruara për vajzat në fushat e STEM, sipas shifrave të marra në webfaqen e MASHT-së, **552 përfituese vajza/gra në fushat e STEM**⁵, janë mbështetur me mjete financiare.

Megjithatë duhet përmendur që MFPT ka ndarë mjete buxhetore në shumën prej 3.5 milionë euro për zbatimin e masave 1.1 – Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë; 1.2 – Mbështetja e të punësuarve të formalizuar; 1.3 – Mbështetja e punësimit të grave; 1.5 – Trajnimi dhe punësimi në TI, pa definuar sa mjete financiare ndahen saktësisht për secilën nënmasë. Vlen të përmendet se përveç këtyre të dhënave zyrtare të ciklit të parë të shpërndarjes së

³ Të dhënat janë marrë nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës

⁴ Vendim për shpalljen e përfituesve të maturantëve për ndjekjen e kurseve në fushën e teknologjisë informatve qasur për herë të fundi më 27.06, i qasëm në <https://spinp.agency/masht/wp-content/uploads/2022/05/vendimi-me-nr-01b-3579-per-perfituesve-te-subvencioneve-te-maturantve-per-ndekjen-e-kurseve-ne-fushen-e-ti.pdf> (qasur në qershor, 2022)

⁵ Vendim për publikimin e listës të rishqyrtuar të përfituesve të mbështetjes financiare për studentet vajza/gra në fushat e STEM, i qasëm në <https://spinp.agency/masht/wp-content/uploads/2022/05/vendimi-me-nr-01b-3578-te-perfituesve-te-mbeshtetjes-financiare-per-studentet-vajza-gra-ne-fushat-e-stem.pdf> (qasur në qershor, 2022)

mjeteve financiare për maturanët dhe vajzat në fushën e STEM, ende nuk ka të dhëna zyrtare, për ciklin e dytë, për të cilin alokimi i mjeteve financiare si propozim është aprovuar.

Masa 1.6 është nënmasa e radhës përmes së cilës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve tenton të integrojë edhe grupet e personave me nevoja të veçanta në shoqëri duke ju ofruar këtyre mundësinë që të ndjekin trajnime për zhvillimin e mëtutjeshëm të shkathtësive të tyre. Kjo është planifikuar të bëhet përmes trajnimit në punë (on the job training) e cila ka për qëllim që të trajnuarit të kenë mundësi më të mira punësimi⁶. Masa është menduar të zbatohet në bashkëpunim me OJQ-të, të cilat do të bëjnë përshtatjen e të trajnuarve dhe biznesit ku zhvillohet trajnimi. Sipas masës 1.6, mbështetja financiare përgjatë kohës së trajnimeve, që përbënë një fazë 3 deri në 6 mujore, të trajnuarit përfitojnë 170 euro në muaj, ndërsa bizneset përfitojnë nga 100 euro në muaj për person. Pas fazës trajnuese, biznesi dhe i trajnuari mund të lidhin marrëdhënie të rregullt pune, e cila po ashtu do të subvencionohet nga shteti, ku për punësim, mbështetja do të jetë 270 euro në muaj për punëtor, për 6 muajt pasues. Kjo masë është me rëndësi të madhe sepse synon mbështetjen e grupeve të cenueshme për të cilat është projektuar pak në këtë Pako. Megjithatë dhe edhe pse vonë, masa ka nisur zbatimin në nivel fillestar, dhe në qershor të vitit 2022 është publikuar njoftimi për pranimin e aplikuesve. Ndërsa sa i përket masës 1.7, është prej masave, për të cilën nuk ka asnjë të dhënë për fillimin e zbatimit të saj në asnjë nivel.

Tabela 2. Niveli i zbatueshmërisë për masën 1

Masa	Niveli i zbatimit	Analizë
1.1 – Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë	Zbatim i plotë	Masa është operacionalizuar dhe ka qenë e hapur për aplikime. Për këtë masë ka filluar pagesa për përfituesit dhe janë ekzekutuar të gjitha, si dhe janë alokuar mjete të reja financiare prej 1 mil. Euro për vazhdimin e zbatimit të saj. (Kjo shumë përfshin edhe nënmasën 1.2 dhe 1.3)
1.2 – Mbështetja për të punësuarit e formalizuar	Zbatim i plotë	Masa është operacionalizuar dhe ka qenë e hapur për aplikime. Për këtë masë ka filluar pagesa për përfituesit dhe ekzekutimi i tyre. Poashtu janë alokuar mjete të reja financiare prej 1 mil. Euro për vazhdimin e zbatimit të saj. (Kjo shumë përfshin edhe nënmasën 1.1 dhe 1.3)
1.3 – Mbështetja e punësimit të grave	Zbatim i plotë	Masa është operacionalizuar dhe ka qenë e hapur për aplikime. Për këtë masë ka filluar pagesa për përfituesit si dhe ekzekutimi i

⁶ Vendim për caktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e masës 1.6 – Mbështetja e personave me nevoja të veçanta në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, i qasshëm në <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/01415B70-161E-4B60-ADD1-35F67326A71E.pdf>, (qasur në qershor, 2022)

		tyre. Poashtu janë alokuar mjete të reja financiare prej 1 mil. Euro për vazhdimin e zbatimit të saj. (Kjo shumë përfshin edhe nënmasën 1.1 dhe 1.2)
1.4 – Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe kanë filluar punën përfituesit në projektin e parë. Projektet e tjera në kuadër të kësaj mase janë ende në proces të implementimit.
1.5 – Trajnimi dhe punësimi në TI	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe deri më tani janë ndarë 5 milionë e 500 mijë euro. Ka qenë i hapur aplikimi për maturantët dhe vajzat në STEM, ku përfitues kanë qenë 943 maturantë dhe 552 vajza/gra në fushën STEM. Cikli i dytë për të cilën janë ndarë fonde ende nuk ka të dhëna.
1.6 – Mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta	Zbatim i kufizuar	Masa ka filluar zbatimin dhe është hapur aplikimi për OJQ. Por ende nuk ka filluar faza trajnuese.
1.7 – Skema e granteve për zanatet	Pa zbatim	Masa nuk ka filluar ende zbatimin dhe rrjedhimisht nuk është operacionalizuar ende.

Masa 2 - Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit

Një ndër problemet më të theksuara në periudhën e pandemisë COVID-19 ishin pasojat ekonomike që pasuan pas periudhës së mbylljes. Pasojat patën impakt afatgjatë, si dhe mbijetesa në periudhën post-Covid 19 u bë më e vështirë sidomos për grupe të cënueshme të shoqërisë. Për shkak të ndryshimeve rrënjësore, hartimi i një plani ambicioz u bë thelbësor dhe qeverive anë e mbanë globit iu fuqizua roli i tyre në aspektin e ringjalljes së ekonomisë. Në mënyrë që pasojat ekonomike të reduktohen dhe ekonomia të ringjallet u krijuan pako rikuperuese globalisht. Kjo për të minimizuar efektet zingjirore që pandemia shkaktoj. Masa të njëjta u ndërmorën edhe në Kosovë, megjithatë duke tentuar të ndryshohen modalitetet e të punuarit dhe të jetuarit për të drejtuar ato drejtë një të ardhme të gjelbër. Pakoja e Ringjalljes Ekonomike është pako që po zbatohet momentalisht duke mbështetur sektorët e caktuar për të fuqizuar, përsheptuar dhe transformuar ekonominë në të qëndrueshme dhe të gjelbër. Masa e dytë synon ‘Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit’ e cila ka për qëllim t’i japë shtysë ekonomisë vendore duke përmirësuar strukturën e përbërjes së PBB-së, kryesisht në sektorët e prodhimit. Për të pasur një ekonomi të qëndrueshme është paraparë zbatimimi i masave si më poshtë:

1. Subvencionimi i kredive investive
2. Mbështetje bizneseve për qasje në financa
3. Investime në TI dhe Inovacion

4. Mbështetja e Eksportit
5. Ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit
6. Rikuperimi i hotelarisë dhe bizneseve të mbyllura

Niveli i Zbatimit

Tashmë në përfundim të procesit të monitorimit, dhe ka ende masa që nuk janë zbatuar plotësisht në kuadër të kësaj mase. Gjatë këtij procesi monitorues INDEP ka vërejtur se disa masa janë zbatuar me intensitet ndërsa të tjera kanë mbetur ende pa u zbatuar. Kjo masë është me rëndësi të madhe për shkak të fushave që ka synuar të mbështesë, e që deri në këtë periudhë nuk ka arritur ta zbatojë plotësisht objektivat që parimisht ka synuar.

Masa 2.1 ka synuar të mundësoj investime të reja përmes mbështetjes për kredi financiare të mundësimit të investimeve të reja, të gjitha bizneset prodhuese dhe përpunuese. Masa ka pasur për qëllim mbështetjen për sektorin prodhues të vendit, konkretisht ndihmën e ndërmarrjeve prodhuese me kredi investive të cilat jepen specifikisht për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe




Figura 2. Niveli i zbatimit të masës 'Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit'

prodhuese brenda kompanisë. Zbatueshmëria e masës nuk është e plotë për arsye se aplikimi për këto kredi do të mbetet i hapur deri në qershor të vitit 2022. Për zbatimin e kësaj mase ka pasur dyshime dhe kundërshtime nga ana e ndërmarrjeve prodhuese. Madje është konsideruar selektive për faktin se mbështet ndërmarrjet prodhuese në afate kufizuese kohore, duke mos pasur parasysh periudhën fillestare të pandemisë. Kjo për faktin se entitetet e tilla mund të subvencionohen vetëm në rast se kanë aplikuar për kredi të llojit të tillë prej tetorit të vitit 2021.

Nënmasa 2.4 'Mbështetja e Eksportit' lidhet direkt me nënmasën 2.1, për shkak se ka për qëllim mbështetjen financiare për ndërmarrjet prodhuese, duke subvencionuar ngritjen e kapaciteteve të stafit menaxherial për certifikim profesional, marketing si dhe pjesëmarrje në trajnime jashtë vendit për mundësinë e gjetjes të tregjeve të reja. Kjo nënmasë u prezantua nga MFPT në të njëjtën kohë me masën 2.1, por ende mbeten vetëm në fazën e parë të operacionalizimit të saj. Vlen të përmendet se në mars të vitit 2022 u ndanë edhe 7.149.864 euro për zbatimin e kësaj mase, dhe Qeveria arsyetoi se mjetet e ndara do të transferohen në programe përkatëse sipas listës së përfituesve që janë pëzgjedhur në kuadër të projektit "Konkurrueshmëria dhe Gatishmëria për Eksport", përkatësisht te "Programit të Granteve të Përputhshme"⁷.

⁷ Vendim mbi caktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e pjesshëm të masës 2.4, i qasshëm në <https://mf.rks.gov.net/desk/inc/media/64326E76-4375-4241-8FA3-D6C1EB226CE6.pdf> (qasur në qershor, 2022)

Poashtu, nënmasa 2.2 ‘Mbështetje bizneseve për qasje në financa’ mbetet ende e zbatuar në mënyrë të kufizuar. Përvec mbështetjes të tarifave të garancisë me 3 milionë euro të FKGGK-së⁸, pjesa e shumës tjetër të premtuar nga Pako mbetet ende pa u vënë në zbatim. Për më tepër duhet të përmendet se Qeveria e Kosovës ka alokuar mjete financiare për nënmasën 2.5 ‘Ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit’ prej 2 milionë e 500 mijë euro⁹, por ende nuk ka filluar operacionalizimi i kësaj nënmasë.

Tabela 3. Niveli i zbatueshmërisë për masën 2

Masa	Niveli i zbatimit	Analizë
2.1 – Subvencionimi i kredive investive	Zbatim i kufizuar	Masa është operacionalizuar dhe është hapur afati për aplikim për subvencionim.
2.2 – Mbështetje bizneseve për qasje në financa	Zbatim i pjesshëm	Masa ka filluar të zbatohet dhe janë ndarë 3 milionë Euro për zbatim të plotë të saj, por ende nuk ka filluar implementimit.
2.3 – Investime në TI dhe Inovacion	Pa zbatim	Masa ende nuk është operacionalizuar dhe nuk ka filluar të zbatohet.
2.4 – Mbështetja e Eksportit	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe është hapur afati për aplikim për subvencionim. Poashtu Qeveria ndau 7.149.864 euro të cilat do të transferohen në programe përkatëse sipas listës së përfituesve që janë pëzgjedhur nga “Programi i Granteve të Përputhshme”
2.5 – Ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit	Zbatim i pjesshëm	Masa ka filluar të zbatohet dhe janë ndarë mjete financiare prej 2 milionë e 500 mijë euro.
2.6 – Rikuperimi i hotelarisë dhe bizneseve të mbyllura	Pa zbatim	Masa ende nuk është operacionalizuar dhe nuk ka filluar të zbatohet.

Masa 3 - Mbështetja për familjen

Përveç shkundjes ekonomike, pandemia Covid-19, shkaktoi pasoja afatgjate në dimensione të ndryshme. Krizat sociale të krijuara nga kjo pandemi ndikuan në rritjen e pabarazisë, papunësisë, diskriminimit, dhe afektuan segmente të ndryshme të popullsisë në mënyra të ndryshme. Duke afektuar sidomos grupet e cënueshme, u pa si tepër e nevojshme ndërhyrja e shtetit përmes

⁸ Lajme, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 11.08.2021, Prishtinë, i qasshëm në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1111>, (qasur në qershor, 2022)

⁹ Vendim 20/50 i Qeverisë së Kosovës, Gazeta Zyrtare, 23.12.2021, Prishtinë i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30> (qasur në qershor, 2022)

politikave të caktuara për të krijuar një masë mbrojtëse në veçanti për kategoritë e rrezikuara dhe të prekura më shumë nga pasojat e pandemisë. Shoqëria kosovare nuk bëri përjashtim dhe sidomos në Kosovë ku skemat për mbrojtje sociale nuk ofrojnë siguri, u pa e domosdoshme ofrimi i platformave të reja për mbrojtje sociale, të cilat ofrojnë siguri bazë të të ardhurave në cdo kohë. Masat e ndërmara u integruan në PRE dhe ofruan mbështetje financiare për familjet që kanë humbur kryefamiljarin, lehonat e papuna, pensionistët e familjet me asistencë sociale. Kjo masë pati të alokuar 50 milionë euro, dhe u shpërnda në gjashtë kategori të ndryshme, si në vijim:

1. Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin
2. Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale
3. Reformimi i Skemës së Asistencës Sociale
4. Kuponë ushqimi për familjet në nevojë
5. Pagesa për lehonat e papuna
6. Mbështetja e likuiditetit familjar
7. Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike
8. Rritja e rezervave shtetërore

Niveli i Zbatimit

Masa e tretë është ndër masat e realizuara në mënyrë të suksesshme dhe ashtu siç është projektuar fillimisht. Kjo sepse Qeveria në mënyrë intensive ka zbatuar secilën nënmasë të saj në ndonjë nivel zbatimi. Masa ka për qëllim mbështetjen dhe përkrahjen e grupeve më të cenueshme. Nënmasa 3.1 ‘Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin’, është masë e zbatuar në plotëni, sepse deri tani është ofruar mbështetje financiare për familjet që kanë humbur kryefamiljarin e tyre. Për më tepër, në shkurt të këtij viti janë ndarë 3.5 milionë euro shtesë për disa masa, ndër të cilat është përfshirë edhe masa 3.1, megjithatë nuk është qartësuar saktë shumën e mjeteve të ridistribuuara për këtë masë. Megjithatë është masë e zbatuar në koordinim me projektimin fillestar të saj.

Sa i përket masës 3.2 dhe masës 3.5, duhet të përmendet që përtej alokimeve të mjeteve financiare për këtë masë, skema për lehonat e papuna është shndërruar në një politikë të përhershme, dhe shtesat për pensionerë poashtu. Kështu që këto masa konsiderohen të jenë zbatuar plotësisht, si dhe të kenë rezultuar më të suksesshme se projektimi fillestar i tyre. Kjo pasi që nevoja për rritjen e mbështetjes financiare për pensionerë ka qenë e padiskutuar, sepse shumica me të cilën janë mbështetur paraprakisht pensionerët ka qenë tejet e vogël për të plotësuar nevojat e këtij grupi shoqëror. Gjithashtu sipas vendimit të Qeverisë të muajit prill 2022¹⁰ të gjithë përfituesit e skemës së asistencës sociale që janë kualifikuar për përfitim kanë marrë vlerën e dyfishtë të asistencës për muajin prill të vitit 2022. Sidoqoftë, mbetet të shihet zbatim i mëtutjëm i masës. Masa 3.5 – pagesa për lehonat e papuna, ka qenë gjithashtu skemë e domosdoshme për fuqizimin e gruas dhe pozitës së saj në shoqëri, kjo pasi që lehonat e papuna paraprakisht nuk janë mbështetur në asnjë lloj forme. Në kuadër të kësaj mase ka filluar edhe zbatimi gradual i programit të shtesave për fëmijë,

¹⁰ Masa për shtimin e mbështetjes për qytetarët e Republikës së Kosovës në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=57255> (qasur në qershor, 2022)

në shuma 20 euro për foshnje dhe 10 për fëmijë, incentivë kjo poashtu shumë e nevojshme për mirëqenien sociale të familjeve kosovare.



Figura 3. Niveli i zbatimit të masës 'Mbështetja për familjen'

Masa 3.3 është masë që ende është në nivelin fillestar të zbatimit. Në dhjetor të viti 2021 është nënshkruar marrëveshje e financimit për 'Projektin e Reformës së Sistemit të Ndhmës Sociale në Kosovë' në mes të MFPT dhe Bankës Botërore¹¹. Marrëveshja është në vlerë prej 45 milionë euro që do të orientohen drejtë përmirësimit të performancës së Skemës së Ndhmës Sociale. Mirëpo përveç nënshkrimit të marrëveshjes nuk ka të dhëna zyrtare mbi rezultatet konkrete kur do të konkretizohet marrëveshja dhe kur do të fillojnë të përfitojnë kategoritë që nënmasa përfshin.

Masa e cila është zbatuar ashtu sic është projektuar në fillim është masa 3.4 - 'Kuponë ushqimi për familjet në nevojë'. Përkundër kësaj Ministria përsëri ka hapur përsëri aplikim për kuponë ushqimor në muajin prill. Zbatimi i kësaj mase kësaj radhe është bërë në bashkëpunim me OJQ që ofrojnë shërbime social dhe shuma ka variuar deri në 50.-Eur për pako ushqimore.¹²

Mbështetja e likuiditetit familjar është synuar përmes masës 3.6. ku Qeveria ka subvencionuar qytetarët e Kosovës 10% të kredive konsumuese, deri në shumën 10.000 euro. Deri në shkurt të vitit 2022 është bërë ekzekutimi i pagesave për **3,396 përfitues** të kësaj mase,¹³ megjithatë Qeveria ka alokuar mjete financiare në vlerë prej 7.300.000,00€¹⁴ për zbatimin kësaj mase si dhe shtimin e mbështetjes për qytetarët e Republikës së Kosovës. Kjo masë nuk ka përfunduar zbatimin e plotë të saj dhe pritet vazhdimi i zbatimit të saj edhe për subvencionimin e aplikuesve të tjerë.

Gjatë periudhës së zbatimit të masave, Qeveria e Kosovës ka konsideruar të nevojshme edhe miratimin e dy masave 3.7 dhe 3.8. Për zbatimin e nënmasës 3.7 janë ndarë mjete buxhetore në vlerë 20 milionë euro. Masa është zbatuar nga Ministria e Ekonomisë e cila ka transferuar këtë shumë parash te KEK për subvencionimin e importit të energjisë elektrike. Gjithashtu plotësisht është zbatuar edhe masa 3.8, për rritjen e rezervave shtetërore. Për këtë masë janë ndarë gjithsej

¹¹ Lajme, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Lajme, 26.10.2021, Prishtinë e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1141> (qasur në qershor, 2022)

¹² Thirrje publike për organizatat jo-qeveritare dhe entitetet tjera që ofrojnë shërbime sociale për kategoritë e cenushme të shoqërisë përmes pakove ushqimor në 2B4DCDBE-3B9F-49CE-895E-1B1227597DBA.pdf (rks-gov.net) (Qasur në qershor, 2022)

¹³ Vendimi nr. 19/50 i Qeverisë së Kosovës, Gazeta Zyrtare, 23.12.2020, Prishtinë, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30> (Qasur në qershor, 2022)

¹⁴ Vendim për ndarjen e mjeteve buxhetore për masën 3.6 i Qeverisë Nr. 10/69 në Vendim-i-mbledhjes-se-72-te-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves-1.pdf (rks-gov.net) (Qasur në qershor, 2022)

mjete financiare prej 10 milionë euro.¹⁵ Këto mjete janë transferuar te Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e cila do të zbatojë këtë masë në koordinim me MFPT.

Tabela 4. Niveli i zbatueshmërisë për masën 3

Masa	Niveli i zbatimit	Analizë
3.1 – Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin	Zbatim i plotë	Masa është operacionalizuar dhe ka përfunduar zbatimin. Tashmë është ekzekutuar pagesa për rreth 3,396 familje që kanë humbur familjarin si pasojë e pandemisë COVID-19. Gjithashtu janë ndarë 3.5 milionë megjithatë nuk është definuar saktë shuma e ndarë për këtë masë.
3.2 – Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale	Masa është shndërruar në politkë të përhershme	Kjo mbështetje financiare është bërë e përhershme.
3.3 – Reformimi i Skemës së Asistencës Sociale	Zbatim i kufizuar	Në kuadër të kësaj nënmasë është bërë marrëveshje me Bankën Botërore, sidoqoftë masa ende është në fillim të zbatimit.
3.4 – Kuponë ushqimi për familjet në nevojë	Zbatim i plotë	Masa është operacionalizuar dhe tashmë është mbyllur afati për aplikim. Përmes saj është tentuar mbështetje për kuzhinat popullore për personat në nevojë. MTFP ka nënshkruar marrëveshjet e mbështetjes financiare me përfaqësuesit e organizatave përfituese. Në muajin prill ka vazhduar zbatimi në bashkëpunim me OJQ.
3.5 – Pagesa për lehonat e papuna	Masa është shndërruar në politkë të përhershme	Masa është operacionalizuar dhe ka filluar edhe zbatimi i pagesave për përfituesit.
3.6 – Mbështetja e likuiditetit familjar	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe është hapur aplikimi për kredi konsumuese. Deri tanë janë ekzekutuar pagesa për 3,396 persona, si dhe janë alokuar mjete të tjera financiare në vlerë prej 7.300.000,00€. Pritet vazhdimi i zbatimit të kësaj mase.
3.7 – Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike	Zbatim i plotë	Janë ndarë mjete buxhetore në vlerë 20 milionë euro. Kjo nënmasë do të zbatohet nga ME cila do të transferojë këtë shumë parash te KEK për subvencionimin e importit të energjisë elektrike.

¹⁵Vendimi 01/65 i Qeverisë së Kosovës, Gazeta Zyrtare, 26.02.2022, Prishtinë i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30> (Qasur në qershor, 2022)

3.8 – Rritja e rezervave shtetërore	Zbatim i plotë	Për këtë masë janë ndarje mjete financiare prej 10 milionë euro. Këto mjete janë transferuar te MINT e cila do të zbatojë këtë masë në koordinim me MFPT.
-------------------------------------	----------------	---

Masa 4 - Mbështetja për publikën

Problemet dhe sfidat me të cilat janë ballafaquar shtetet para pandemisë, u vunë në pah dhe u bënë edhe më të dukshme pas pandemisë. Sisteme shëndetësore të kollapsuara, varfëria ekstreme, cilësia e dobët e edukimit, papunësia, pabarazia, imigrimi janë sfida që u thelluan edhe më tej në periudhën pandemike. Për të fuqizuar sektorët me rëndësi vitale u ndërmorën masa rikuperuese edhe në Kosovë. Një ndër masat me vlerë të rëndësishme, veçanërisht për funksionimin e sektorëve të ndryshëm si shëndetësia arsimit dhe kultura është edhe masa e katërt e PRE-së apo Mbështetja për Publikën. Kjo masë ka për qëllim përveç tjerash edhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike. Zbatimi i mirëfilltë i masës ka pasur për synim kryesor fuqizimin e sektorëve të caktuar për rritjen e mirëqenies duke ndihmuar njëkohësisht edhe rikuperimin nga pandemia si dhe duke targetuar edhe problemet afatgjate në Kosovë si sistemin shëndetësor, institucionet arsimore, mbështetjen e kulturë e të tjerëve në vijim:

1. Mbështetja për shëndetësinë
2. Mbështetja për arsimin
3. Mbështetja e Kulturës dhe Sportit
4. Mbështetja e sigurisë
5. Mbështetja e mërgatës
6. Mbështetja e ndërmarrjeve publike

Niveli i Zbatimit

Në periudhën fillestare të zbatimit të masës 4.1 u alokuan 2.7 milionë euro, mjete financiare të cilat u ndanë për mbështetjet financiare të stafit mjekësor në sektorin publik me pagë shtesë prej 10% të pagës së rregullt bruto, jo më pak se 60 Euro për muajt gusht, shtator dhe tetor të vitit 2021. Në periudhën dhjetor- shkurt janë alokuar fonde të tjera prej 3 milionë euro, për vazhdimin e zbatimit të kësaj mase, megjithëse nuk të dhëna të zyrtare nëse këto mjete janë shpërndarë dhe masa ka vazhduar të zbatohet në ndonjë mënyrë. Poashtu masa 4.2 që përfshin mbështetjet financiare për arsim ka mbetur pjesërisht e zbatuar për shkak që përveç vendimit të marrë për ndarjen e shumës prej 4 milionë e 110 mijë euro në dhjetor të vitit 2021, nuk ka të dhëna zyrtare për zbatimin e masës. Megjithatë INDEP, konkludon që mjetet financiare të alokuara për masën 4.2 janë alokuar për shpërndarjen e mbështetjes financiare për vajzat në fushat e STEM, meqenëse MASHT ka zbatuar këtë masë. Gjithsesi, INDEP nuk ka mundur të marrë të dhëna zyrtare për zbatimin e kësaj mase.

Duhet të përmendet se për masën 4.3 – Mbështetja e Kulturës dhe Sportit, në gusht janë ndarë 5 milionë euro për Ministrinë e Kulturë, Rinisë dhe Sportit, të cilat mjete është paraparë të investohen në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, sportet e gjera dhe përkrahjen e kulturës e rinisë në përgjithësi. Poashtu në shkurt të vitit 2022, Qeveria ka ndarë 100 mijë euro të tjera për MKRS-në për të zbatuar Pakon e Ringjalljes Ekonomike.¹⁶ Edhe pse MKRS ka të alokuara më shumë se 5 milionë euro, nuk ka të dhëna zyrtare si janë zbatuar këto masa. Megjithëse mund të konkludohet se masa është zbatuar, pasi që MKRS ka qenë mjaftë aktive në këto fusha, kohët e fundit, kjo nuk mund të vërtetohet sepse nuk ka ndërlidhje me aktivitetet që zbaton Ministria dhe Pakon e Ringjalljes.

Masa 4.4 - 'Mbështetja e Sigurisë' është masë tejet e rëndësishme për Republikën e Kosovës. Në kuadër të kësaj mase MFPT ka themeluar Fondin e Sigurisë, për të përmbushur nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Kështu, MFPT ka hapur llogarinë zyrtare bankare për pranimin e fondeve nga qytetarët e RKS-së dhe diaspora për të kontribuar në Fond. Megjithëse është hap tejet i rëndësishëm i ndërmarrë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, themelimi i këtij Fondi ka lënë vend për kritika dhe debate. Kjo sepse ka më shumë se 3 muaj që është themeluar dhe për publikun ende nuk është e njohur shuma e grumbulluar në Fond, si rezultat i donacioneve të ndryshme.

'Mbështetja e mërgatës' apo masa 4.5 është masa e radhës që ka pasur objektivë lehtësimin e barrës financiare që mërgimtarët kanë për shkak të limitimit të zbatimit të Kartonit të Gjëlber në Kosovë. Përmes kësaj mase Qeveria fillimisht ka reduktuar kostot e policës kufitare për mërgimtarët që vijnë në Kosovë përmes Byros Kosovare të Sigurimit, i cili ka qenë autoriteti zbatues. Por prej janarit të vitit 2022, qytetarët e Kosovës që kanë targa të huaja, paguajnë policën e plotë në sportelet e BKS-së, deri sa të gjithë më pas e kanë të drejtën e rimbursimit duke aplikuar në platformën e-Kosova¹⁷.

Nënmasa e fundit e masës 4 'Mbështetja e Ndërmarrjeve Publike' ka filluar gjithashtu zbatimin e saj. Mjete financiare në shumën 10 milionë e 860 mijë euro, janë ndarë nga Qeveria e Kosovës për të mbështetur financiarisht ndërmarrjet publike.¹⁸ Nga zbatimi i masës në fjalë përfitojnë ndërmarrjet publike qendrore dhe lokale që kanë vështirësi financiare, si pasojë e përballjes me pandeminë. Ndërmarrjet publike do të kenë mundësinë e huamarrjes me kthim pa interes, për të përballuar kështu shpenzimet operative dhe mbulimin e obligimeve financiare. Fillimisht janë mbështetur ndërmarrjet si Trepça Sh.A dhe Telekom Sh.A, të cilat kanë rrezikuar humbjen e licensës së punës,




Figura 4. Niveli i zbatimit të masës 'Mbështetja për Publikën'

¹⁶Ndarja e mjeteve financiare për masën 4.3, në [Mbledhja e 62-të e Qeverisë së Kosovës - Zyra e Kryeministrit të Kosovës \(rks.gov.net\)](https://rks.gov.net) (qasur në qershor, 2022)

¹⁷Të dhënat janë marrë nga Byroja Kosovare e Sigurimit në Kosovë

¹⁸Vendim nr. 01/53 i Qeverisë së Kosovës, Gazeta Zyrtare, 31.12.2021, Prishtinë i qasshëm në <https://gzk.rks.gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30> (qasur në qershor, 2022)

në rast të mos mbulimit të obligimeve financiare që ato kanë. Për më tepër në muajin maj, MFPT dhe ndërmarrjet publike: Posta e Kosovës, Infracos, Trainkos, KRU Prishtina dhe Telekom i Kosovës kanë nënshkruar sot marrëveshjet e nën-huazimit në vlerë totale prej rreth 5 milionë euro¹⁹.

Tabela 5. Numri i policave kufitare gjate viteve 2020-2021

Faturimi sipas Memorandumit të bashkëpunimit Nr. 611/20 të Datës 30.07.2020 (Viti 2020)						
NR	Data	Pershkrimi	Nr I Polisave te Shitura (Masa 4.5)	Faturuar	E Paguar	E pa paguar
1	15-Sep-20	Gusht	12,279	€ 159,627.00	€ 159,627.00	€ -
2	15-Sep-20	Gusht	3,179	€ 41,327.00	€ -	€ 41,327.00
3	6-Oct-20	Shtator	7,252	€ 94,276.00	€ 94,276.00	€ -
4	6-Oct-20	Shtator	2,967	€ 38,571.00	€ -	€ 38,571.00
7	18-Nov-20	Tetor	13,658	€ 177,554.00	€ 177,554.00	€ -
8	18-Nov-20	Tetor	3,951	€ 51,363.00	€ -	€ 51,363.00
10	11-Dec-20	Nentor	4,804	€ 62,452.00	€ 62,452.00	€ -
11	11-Dec-20	Nentor	2,693	€ 35,009.00	€ -	€ 35,009.00
13	9-Feb-21	Dhjetor	28,638	€ 372,294.00	€ 372,294.00	€ -
14	9-Feb-21	Dhjetor	9,742	€ 126,646.00	€ -	€ 126,646.00
Gjithsej			89,163	€ 1,159,118.99	€ 866,202.99	€ 292,916.00

Faturimi sipas Memorandumit të Bashkëpunimit Nr. 708/21 të Datës 24.06.2021 (Viti 2021)						
NR	Data	Pershkrimi	Nr I Polisave te Shitura (Masa 4.5)	Faturuar	E Paguar	E pa paguar
1	6-Aug-21	Korrik	101,466	€ 1,319,058.00	€ 1,319,058.00	€ -
2	6-Aug-21	Korrik	12,943	€ 168,259.00	€ -	€ 168,259.00
4	6-Sep-21	Gusht	64,345	€ 836,485.00	€ 836,485.00	€ -
5	6-Sep-21	Gusht	7,561	€ 98,293.00	€ -	€ 98,293.00
7	30-Sep-21	Shtator	10,866	€ 141,258.00	€ 141,258.00	€ -
8	30-Sep-21	Shtator	1,602	€ 20,826.00	€ -	€ 20,826.00
10	30-Oct-21	Tetor	14,596	€ 189,748.00	€ 189,748.00	€ -
11	30-Oct-21	Tetor	1,848	€ 24,024.00	€ -	€ 24,024.00
13	30-Nov-21	Nentor	8,646	€ 112,398.00	€ 112,398.00	€ -

¹⁹ Lajme nga MFPT në <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,2,1190> (qasur në qershor, 2022)

14	30-Nov-21	Nentor	1,276	€ 16,588.00	€ -	€ 16,588.00
15	10-Jan-22	Dhjetor	43,756	€ 568,828.00	€ 568,828.00	€ -
16	10-Jan-22	Dhjetor	7,590	€ 98,670.00	€ -	€ 98,670.00
Gjithsej			276,495	3,594,435.00	3,167,774.99	426,660.00²⁰

Tabela 6. Niveli i zbatueshmërisë për masën 4

Masa	Niveli i zbatimit	Analizë
4.1 – Mbështetja për shëndetësinë	Zbatim i pjesshëm	Fillimisht janë ndarë 2.7 milionë për mbështetje të stafit mjekësor në sektorin publik dhe këto mjete janë alokuar në vitin 2021. Më pas janë ndarë 3 milionë Euro për vazhdimin e zbatimit të kësaj mase.
4.2 – Mbështetja për arsimin	Zbatim i pjesshëm	Janë ndarë mjete financiare 4 milionë e 110 mijë euro për mbështetjen financiare për arsimin.
4.3 – Mbështetja e Kulturës dhe Sportit	Zbatim i plotë	Janë ndarë 5 milionë Euro për këtë masë si mbështetje ndaj aktiviteteve kulturore dhe sportive.
4.4 – Mbështetja e sigurisë	Zbatim i pjesshëm	MFPT ka themeluar Fondin e Sigurisë, ku qytetarët e Kosovës dhe diaspora përmes llogarisë bankare kanë bërë donacione, por shuma e grumbulluar nga donacionet ende është e panjohur.
4.5 – Mbështetja e mërgatës	Zbatim i plotë	Janë ndarë 5 milionë Euro për këtë masë si mbështetje ndaj mërgatës. Që nga fillimi i vitit 2022 të gjithë mërgimtarët me targa të huaja që paguajnë policën kufitare ajo shumë iu subvencionohet.
4.6 – Mbështetja e ndërmarrjeve publike	Zbatim i plotë	Janë ndarë mjete financiare prej 10 milionë e 860 mijë euro për të mbështetur financiarisht ndërmarrjet publike.

Masa 5 - Investimi në infrastrukturë dhe ambient

²⁰ Të dhëna zyrtare të marra nga Byroja Kosovare e Sigurimit

Qeveritë e shteteve të ndryshme kanë tentuar që përmes pakove ekonomike të adresojnë edhe ndryshimet klimatike ndër tjera sfida që do të duhej të rindërtoheshin më mirë në periudhën post-pandemike. Shumë vende, e kanë parë integrimin e parimeve të gjelbra në rindërtimin e ekonomisë përveç si sfidë, në të njëjtën kohë edhe mundësi për të transformuar habitatin ku jetojmë në një vend të qëndrueshëm dhe miqësor me mjedisin. Natyrisht që të rindërtuarit më mirë nuk nënkupton vetëm adresimin e ndryshimeve klimatike por nënkupton edhe luftën e ndikimeve negative sociale dhe ekonomike që ka pasur pandemia covid-19. Për këtë arsye pakot e projektuara për rimëkëmbje ekonomike kanë pasur të integruar këto tri komponenta me rëndësi jetike në kohët që po jetojmë.

Kosova poashtu ka adresuar sfidën e ndryshimeve klimatike në projektimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike duke integruar masën 5 – investimi në infrastrukturë dhe ambient. Kjo masë ka të alokuar mjete financiare në vlerë prej 100 milionë euro për zbatim, dhe i dedikohet tërësisht investimeve dhe projekteve strategjike që lidhen me rikuperimin e gjelbër dhe ruajtjen e ambientit. Megjithatë, edhe pse masë me rëndësi të jashtëzakonshme, praktikisht është bërë shumë pak në këtë drejtim.

INDEP, përgjatë gjithë procesit monitorues të zbatimit të PRE-së, ka analizuar projektimin dhe zbatimin e Pakos, megjithatë nuk ka parë progres në këtë drejtim dhe as përmbushje të objektivave të synuara në projektimin fillestar të Pakos. Megjithëse masa përmban investime enorme si në filterët e TC Kosova B e projekte të tjera që përmirësojnë jetën e qytetarëve dhe cilësinë e ajrit në përgjithësi në Kosovë, ende nuk ka diçka konkrete në këtë drejtim. Vlen të theksohet se është prezantuar projekti i linjës hekurudhore Prishtinë-Durrës, dhe është nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi në mes të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë për studimin e fizibilitetit dhe projekt-idesë për lidhjen hekurudhore Durrës – Prishtinë²¹. Përkundër kësaj marrëveshje nuk ka ndonjë rezultat të prekshëm nga zbatimi i kësaj mase. INDEP konsideron se këtë fakt shqetësues duke qenë se zbatimi i masës është inaktiv në periudhë 1-vjecare dhe ka disbalanc të thellë në mes të zbatimit të masave. Për më tepër, duke ditur mjetet financiare të alokuara dhe rëndësinë e masës, si dhe planifikimin për të rindërtuar duke u bazuar në parime të gjelbra zbatimi i kësaj mase në nivel minimal është tejet shqetësuese.

Bonot e Diasporës

Pakoja e Ringjalljes ka pasur të përfshirë edhe pati për qëllim krijimin e një thesari të buxhetit për investime nga diaspora, pati filluar zbatimin e saj, përkundër interesimit jo të madh nga ana e shqiptarëve nga diaspora për investim. Gjithsej nga Bonot e Diasporës, u mbledhën mjete financiare prej 10.43 milionë Euro, nga 20 milionë euro në vlerë Bonosh që ishin ofruar për shitje me qëllim që paratë e dërguara nga diaspora të kanalizohen dhe të shfrytëzohen për investime në vend. Megjithatë kjo masë nuk mund të thuhet se ka përmbushur synimin e vet sepse përveç që u shpjegua në mënyrë të vakët që këto investime do të alokohen për ringjalljen e ekonomisë së vendit nuk u konkretizua dhe përcaktu saktësisht ku do të investohen këto mjete financiare.

²¹Marrëveshja për studimin e fizibilitetit dhe projekt-idesë për lidhjen hekurudhore Durrës – Prishtinë, e qasshme në <https://kryeministri.rks-gov.net/u-mbajt-mbledhja-e-tete-e-perbashket-e-qeverise-se-kosoves-dhe-qeverise-se-shqiperise/> (qasur në qershor, 2022)

Mbështetje e njëhershme në vlerë prej 100 euro

Përvec masave të cilat janë projektuar në fillim dhe janë zbatuar gjatë vitit 2021 dhe 2022, gjatë këtij procesi janë miratuar dhe zbatuar ad-hoc edhe masa të tjera. Njëra ndër to është mbështetja në vlerë prej 100 euro për punëtorët e sektorit privat të cilët janë kualifikuar për përfitim, e kriteri kualifikimi ishte që vlera e pagës primare të mos kalonte shumën 1.000 Euro. Përfitues të kësaj mase ishin poashtu punonjësit e sektorit publik, që poashtu marrin pagë primare deri në 1.000 euro. Grupi i tretë i mbështetur me shumën financiare të njëhershme në vlerë prej 100 euro ishin të gjithë studentët aktivë dhe të rregullt që janë të regjistruar në universitete publike dhe private²².

Përfituesit nga sektori privat
336 mijë ²³

Përfundime

Pakoja e Ringjalljes Ekonomike është një ndër pakot më të rëndësishme dhe me vlerën më të lartë të mjeteve financiare të alokuara për zbatimin e saj. Pakoja ka pasur gjithsej 420 milionë euro të ndarë për zbatim, duke tentuar kështu rikuperimin dhe ringjalljen ekonomike të Kosovës në periudhën post-pandemi. Përvec dimensionit ekonomik, PRE ka të integruar si shtyllë edhe dimensionin social e mjedisor, në të cilat është dashur të ndërvehojë patjetër, konsideruar sfidat që përballemi në këtë periudhë. Pakoja e Ringjalljes ka për objektive rikuperimin ekonomik, duke formalizuar atë dhe duke shtrirë mundësi të reja për grupe shoqërore të caktuara si të rinjtë, rritjen e bruto-produktit vendor duke mbështetur sektorët prodhues si dhe rritjen e përgjithshme ekonomike. Poashtu kjo pako ka synuar edhe rritjen e mirëqenies sociale duke fuqizuar gruan dhe pozitën financiare të saj, pensionistët si dhe grupet e personave me nevoja të veçanta.

INDEP ka monitoruar procesin e projektimit dhe zbatimit të masave të Pakos së Ringjalljes dhe konkludon që deri në këtë fazë shumica e masave kanë filluar fazat fillestare apo janë zbatuar deri në një masë, në përjashtim të disa masave të caktuara. Vlen të theksohet se gjatë procesit të përpilimit të masave ndihmëse të Pakos së Ringjalljes, Qeveria si përgjegjëse kryesore për Pakon, nuk ka mbajtur konsultime publike, të cilat konsiderohen të domosdoshme në rastet kur një iniciativë e tillë merr formë reale. Konsultimi me qytetarët, shoqërinë civile e institucionet tjera të pavarura konsiderohet tepër e nevojshme në raste të tilla duke qenë se ky projekt ka rëndësi të madhe për qytetarët dhe është mjaft e kushtueshme. Përfshirja e palëve të treta në cdo iniciativë të Qeverisë konsiderohet jetike dhe e nevojshme për rritje të llogaridhënies dhe transparencës. Duke qenë se platforma digjitale për konsultime publike ekziston dhe është shumë funksionale, mos-

²² Vendimi për mbështetjen e njëhershme në vlerë prej 100 euro në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=57255> (qasur në qershor, 2022)

²³ Të dhëna të marra nga ATK

përdorimi i saj në raste kur miratohen dhe implementohen projekte në përmasa kaq të mëdha konsiderohet lëshim dhe neglizhencë e thellë nga ana e Qeverisë.

Gjatë procesit të monitorimit të projektimit dhe zbatimit të masave të Pakos së Ringjalljes, është vërejtur se që në planifikim të Pakos kanë munguar kriteret dhe pritjet e kuantifikuara të të dhënave si dhe objektivat e matshme. Në përgjithësi, kjo vjen si pasojë e mungesës së të dhënave të disagreguara ekonomike dhe sociale që publikohen në baza periodike në Kosovë, mirëpo është konsideruar tepër i nevojshëm vendosja e objektivave dhe indikatorëve matës që do të duhej të bazoheshin në plane veprimi të mirëmenduara dhe planifikuara për zbatim gjatë gjithë procesit të zbatimit. Ndërsa gjatë këtij procesi përveç që nuk ka pasur zbatim koherent të masave duke munguar ekzekutimi koherent dhe paralel i masave, masa të caktuara janë prioritizuar dhe janë zbatuar intensivisht ndërsa masa të tjera nuk kanë filluar zbatimin fare apo janë zbatuar në nivel të kufizuar. Kjo ka sjellur deri tek mungesa e interpretimit objektiv dhe e bazuar në të dhëna të kuantifikuara, si dhe ka rezultuar në interpretim subjektiv nga ana e institucioneve zbatuese. Natyrisht ka pasur institucione që kanë ofruar të dhëna statistikore, por kjo nuk ka gjetur zbatim në të gjitha institucionet.

Sa i përket zbatimit të masave prej periudhës kur ka filluar operacionalizimi i masave, në korrik të vitit 2021 dhe deri në muajin qershor të vitit 2022, 10 masa janë zbatuar në plotëni, 9 janë zbatuar në mënyrë të pjesshme, 3 në nivel të kufizuar, dhe pa zbatuar kanë mbetur 3 masa. Masa 5 është e përjashtuar nga niveli matës i zbatimit, për arsye se gjatë kësaj periudhe 1 vjecare prej muajit korrik deri në muajin qershor nuk ka filluar as prezantimi i masave që kanë për t'u zbatuar nën këtë masë. Gjithsesi muajin e fundit është prezantuar një projekt i cili është ende në fazë fillestare dhe konsiderohet zbatim i kufizuar.

Përfundimisht sa i përket zbatimit të masave, ka masa të cilat janë shndërruar në politika, gjë që është mirëpritur dhe konsideruar pozitive duke pasur parasysh nevojën që kanë pasur grupe të caktuara shoqërore për mbështetje financiare koherente. Një ndër to është edhe 'Skema e lehonave të papuna', të cilat me fillimin e zbatimit të kësaj mase do të mbështeten me shuma financiare edhe në vazhdim. Mund të themi që shumica dërrmuese e masave është zbatuar, duke filluar nga masa e parë e deri te e katërta, përjashtim ka bërë masa e 5 e cila ka të alokuar vlera të mëdha mjeteshtetare si dhe ka të projektuara plane të rëndësishme, megjithatë zbatimi i saj është i kufizuar. Megjithatë Pakoja është parë edhe si jo-gjithëpërfshirëse duke diskriminuar grupe të caktuara shoqërore dhe duke mos mbuluar financiarisht segmente shoqërore në asnjë formë. Për më tepër duke konsideruar se masa të pakta janë projektuar për të rezultuar në rimëkëmbje të gjelbër, pak është prekur dimensionimi mjedisor në pako dhe nuk mund të thuhet se është bërë ose ka filluar një tranzicion për një të ardhme më të gjelbër. Por, përgjithësisht mund të konstatojmë se niveli i zbatimit deri në këtë periudhë qëndron mirë, me shumicën e masave të aplikuara dhe zbatuara në nivele të ndryshme, megjithatë zbatimi i Pakos së Ringjalljes nuk ka përfunduar ende dhe ka masa të cilat janë të projektuara dhe buxhetuara të zbatohen deri në fund të vitit 2022 dhe më tej. INDEP konsideron se megjithëse Pakoja nuk është zbatuar ende dhe ka masa që kanë ngecur në zbatim, në përgjithësi ka ndihmuar në rimëkëmbjen socio-ekonomike të Kosovës, në periudhën post-pandemike.



Ky publikim mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD) një projekt i Fondit Gjerman Marshall të SHBA-ve dhe popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo opinionet e BTD, GMF, USAID ose Qeverisë së SHBA-së.”